



A.nr.602/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.602/2026, të datës 05.06.2026, të parashtruar nga ankuesja A.D-Ç nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Dixhitalizimit dhe Administratës Publike, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.06.2026, nxjerrë, këtë:

## V E N D I M

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.602/2026, e datës 05.06.2026, e parashtruar nga ankuesja A.D-Ç.

## A r s y e t i m

Ankuesja A.D-Ç (*tutje referuar ankuesja*), më datë 05.06.2026, përmes e-mailit [ankesa.kpmsbck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsbck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.602/2026, kundër Vendimit me numër 02/2026 të datës 03.06.2026, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Dixhitalizimit dhe Administratës Publike, lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimi me numër të referencës: RN000199599, për pozitën e punës *Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Tregtisë dhe Inovacionit*, të shpallur nga Ministria e Dixhitalizimit dhe Administratës Publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë së Ministria e Dixhitalizimit dhe Administratës Publike me datë 20.04.2026, ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN000199599, për pozitën e punës *Sekretar i Përgjithshëm*, me afat të aplikimit nga data 21.04.2026-20.05.2026.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del së në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo, sipas Vendimit me numër 02/2026 të datës 03.06.2026 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, të njëjtës i është refuzuar aplikacioni më arsyetimin se nuk ka përmbushur kriterin e përvojës së punës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton vendimin për refuzimin e aplikacionit, më pretendimin se ka dorëzuar dokumentet që

dëshmojnë përvojën e punës, dhe së ka bashkangjitur dokumentet referente të cilat janë të përshtatshme dhe relevante për pozitën e punës rekrutuese të shpallur sipas referencës RN00019599. Kërkon që të rishqyrtohet aplikacioni, të shfuqizohet Vendimi me numër 02/2026 i datës 03.06.2026, dhe mundësimin në vazhdimin e procedurës së rekrutimit.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht, nenit 39, paragrafi 12 i cili përcakton se: “12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”, si dhe nenit 17 të Rregullores 07/2025 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 05.06.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidatja për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër vendimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses të datës 05.06.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimi sipas konkursit me Nr. Ref: RN00019599, fakt ky i konfirmuara edhe përmes emailit të datës 11.06.2026, të DMZP-së, rrjedhë se ankesa e ankueses A.nr.602/2026, e datës 05.06.2026 është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.602/2026 nuk mohon të drejtën e ankueses që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse. Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.602/2026

**Merlinda RAMAJ**

*Procesmbajtëse*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses, A.D-Ç;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministritë së Dixhitalizimit dhe Administratës Publike dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.